



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

Nr. 21839/1 Prot.

Lezhë, më 16 / 01 /2026

PROCES-VERBAL

KONSULTIM PUBLIK NË LIDHJE ME DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË FONDIT PYJOR KOMBËTAR, SHOQËRISË ONE ALBANIA SHA, PËR ANTENAT E TELEFONISË CELULARE, FSHATI BALLDRE, NJËSIA ADMINISTRATIVE BALLDRE DHE FSHATI MABË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DAJÇ, BASHKIA LEZHË

Data dhe vendi i mbajtjes së takimit: 13.01.2026, ora 13:00, në ambientet e një lokali pranë Njesisë Administrative Balldre, Bashkia Lezhë.

Pjesëmarrësit në takim nga ana e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore:

1. Kryetari i Këshillit Bashkiak Z. Ndue Luli.
2. Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve Z. Paulin Gjergji.
3. Përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave Z. Artan Palushi.
4. Anëtare e Këshillit Bashkiak Znj. Alfrida Marku.
5. Administrator i Njesisë Administrative Balldre Z. Redon Gjeloshi.
6. Administrator i Njesisë Administrative Dajç Z. Gentjan Marku.
7. Sekretari i Këshillit Bashkiak Znj. Florida Çunaj.

Territori që mbulon konsultimi publik: Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezultojnë që sipërfaqja e parashikuar për tu dhënë në përdorim është: **0.02ha** për antenën e telefonisë celulare me kod LE1004 dhe **2.43 km** rrugë auto ekzistuese e shtrirë në këto parcela **18b, 17a, 17b, 15h, 16, 32** dhe sipërfaqja prej **0.02 ha** për antenën me kod SH2006 dhe **0.501 km** rrugë ekzistuese e shtrirë në pasurinë numër **1 ZK 1533(prone shtet)**. Këto sipërfaqe shtrihen në parcelat pyjore **18b, 17a, 17b, 15h, 16, 32** që bëjnë pjesë në ekonominë pyjore "**Mali i Kakarriqit**", Njësia Administrative Balldre e cila është në pronësi të **Bashkisë Lezhë** dhe në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

pasurinë numër **1 ZK 1533** në Mabë Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë e cila është pronë shtet.

Numri i Personave që marrin pjesë në takim: 28 .

Numri i femrave që marrin pjesë në takim: 10 femra.

Çështja 1 për diskutim: Procedura e dhënies në përdorim të fondit pyjor kombëtar, shoqërise ONE ALBANIA SHA, për antenat e telefonisë celulare.

Shoqëria **ONE ALBANIA SH.A** ka paraqitur kërkesën me numër 2322/3 prot datë 13.10.2025 pranë Bashkisë Lezhë, për rinovim kontratash për stacionet Mabë -1753(antena me kod SH2006) dhe Kolajakaj 1826(antena me kod LE1004) sipërfaqe pyjore që janë pjesë e fondit pyjor brenda territorit të Bashkisë Lezhë.

Bazuar në ligjin 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", si dhe në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", kërkesa i drejtohet Këshillit Bashkiak për miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore për antenën e telefonisë celulare në fshatin Mabë, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë me një sipërfaqe prej **0.02 ha** dhe rrugë ekzistuese me gjatësi **0.501km** që kalon në sipërfaqe pyjore në pronësi shtet, brenda territorit të Bashkisë Lezhë për antenën me kod SH2006 dhe miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore për antenën e telefonisë celulare në fshatin Balldre, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë me një sipërfaqe prej **0.02 ha** dhe rrugë ekzistuese me gjatësi **2.43 km** që kalon në sipërfaqe pyjore në pronësi të Bashkisë Lezhë për antenën me kod LE1004.

Në këto raste, sipas VKM-së së sipërcituar nuk bëhet heqje nga fondi pyjor si dhe pakësim të volumit drusor dukë qenë së sipërfaqet që propozohen të jepen në përdorim i ka patur shoqëria në përdorim edhe më parë në kontraktim me ish-komunat.

Shoqëria **ONE ALBANIA SH.A** ka patur kontratë përdorimi me ish-Komunën Dajç e cila ka përfunduar në janar të vitit 2020 dhe me ish-Komunën Balldre e cila ka përfunduar në qershor të vitit 2019.

Bashkia Lezhë nëpërmjet marrëveshjes numër 5917/1 datë 19.05.2025, është dakortësuar me shoqërinë **ONE ALBANIA SH.A** për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për secilën kontratë dhe aktualisht janë arkëtuar të gjitha detyrimet dhe kjo shoqëri nuk rezulton të jetë debitore ndaj institucionit tonë.

Procedura nuk i nënshtrohet garës së prokurimit publik duke qenë se në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik", pika **22** gërma **g** thuhet shprehimisht:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bëjnë përjashtim nga konkurrimi publik dhënia e sipërfaqeve në përdorim rastet kur persona fizikë/juridikë janë të pajisur me leje/licencë nga institucionet përkatëse për veprimtaritë që kanë të bëjnë me:

g) procedurat në zbatim të ligjit për ndërtimin e antenave të komunikimit radiotelevizive dhe telefonisë celulare;

Nga ana e Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë është përgatitur raporti tekniko-ekonomik për sipërfaqet pyjore që preken nga “Antena të telefonisë celulare dhe infrastrukturë ndihmëse (rrugë auto ekzistuese)”.

Çështja 2 për diskutim: Largësia e vendosjes së antenave celulare nga qendrat e banuara, impakti që kanë tek banorët instalimi i antenave dhe pse pikërisht duhet të vendosen në këto dy njësi administrative.

_Znj. Alfrida Marku

Në fshatin Mabë, Njesia Administrative Dajç, largësia nga qendrat e banuara është **0.501 km** që kalon në sipërfaqe pyjore në pronësi shtet, brenda territorit të Bashkisë Lezhë për antenën me kod SH2006 si dhe në fshatin Balldre, Njësia Administrative Balldre për antenën me kod LE1004, largësia nga qendrat e banuara është **2.43 km** që kalon në sipërfaqe pyjore në pronësi të Bashkisë Lezhë. Rezatimi i valëve shpërndahet në ajër ku ndërliken me njëra tjetrën nëpërmjet lartësisë pasi janë 40-50m lart dhe nuk ka ndikim tek banorët. Për sa i përket zonave, Përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave saktësoi që zona nuk është caktuar nga ne se ku të vendosen, antenat janë të vendosura para shumë vitesh dhe janë në tokë shtet, ku Bashkia Lezhë i ka marrë Kompanisë në fjalë të gjitha detyrimet e prapambetura që nga viti 2016 dhe për tu legjitimuar sërish duhet rinovuar kontrata e re e cila është në dorë për miratimin ose jo nga Këshilli Bashkiak.

Konkluzione nga takimi:

U rekomandua që ti kërkohet kompanisë që të sjelli dokumente të tjera si; Leje Ndwrtimi, Leje Mjedisore dhe Leje per Rrezatimin e valeve.

Struktura përgjegjëse

për mbajtjen e proces-verbalit :

ARTAN PALUSHI

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

FLORIDA CUNAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË





REPUBLIKA E SHQIPËRIË

